



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/165
Datë: 12.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2023

1. Tërhiqen nga Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2023, Projektligjet si në vijim:
 - 1.1. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.04/L-010 për Bashkëpunim Ndër komunal (MAPL);
 - 1.2. Projektligji për Planifikim Hapësinor (MMPHI);
 - 1.3. Projektligji për Harmonizimin e Ligjeve të Veçanta me Ligjin Nr. 08/L- 067 për Inspektimet (ZKM); dhe
 - 1.4. Projektligji për Harmonizimin e Ligjeve të Veçanta me Ligjin Nr. 04/L- 202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave (ZKM).
2. Shtyhet afati i miratimit në Qeveri deri më 31 dhjetor 2023 për: Projektligjin për Banimin Social (MMPHI).
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin t'ia dërgojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/165
Datë: 12.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin "Projekti për Forcimin e Qeverisjes Digitale për Ofrimin e Shërbimeve".
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/165
Datë: 12.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 14, paragrafi 1. të Ligjit Nr. 08/L-0193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-213 dhe Ligjin Nr. 08/L-235, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja buxhetore në shumë prej 290.000.00 € (dyqindenëntëdhjetë mijë euro) për subvencionim të ndërtimit të shtëpive për komunitetet jo shumicë.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232, nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva", dhe transferohen në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, në nën-programin "Administrata Qendrore" me kod 11301, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Autorizohet Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve që përmes një Vendimi të veçantë të bëjë shpërndarjen e mjeteve buxhetore të ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi tek familjet përfituese.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve gjatë muajit korrik të vitit 2019 kishte nisur Projektin "Ndërtimi i shtëpive - projektet për komunitetet" ku parashihej të ndërtoheshin 273 (me shkronja: dyqind e shtatëdhjetë e tre) shtëpi. Përfitues të këtyre shtëpive ishin familjet nga komunitetet jo shumicë dhe shtëpitë do ndërtoheshin për qëllime të banimit social. Përmes këtij Projekti, Ministria kishte marrë obligimin që t'i financojë aktivitetet e ndërtimit të shtëpive.

Gjatë implementimit të Projektit, ka pasur pezullime dhe më pas ndërprerje të punimeve ku si rezultat shtëpitë e destinuar për komunitetet nuk kanë arritur të përfundohen në tërësi.

Në këtë kontekst, me qëllim të përfundimit të shtëpive të nisura për ndërtim dhe përmbushjes së detyrimit ndaj përfituesve të Projektit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndarë 290.000.00 € (dyqindëntëdhjetë mijë euro) për subvencionim të ndërtimit të shtëpive dhe realizimit të Projektit.

Duke u bazuar në sqarimin e mësipërm, u vendos si në diapozitivin e këtij Vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/165
Datë: 12.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 49, 50 dhe nenit 52 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 38 të Ligjit Nr. 08/L-099 për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore, nenit 24 të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-213 dhe Ligjin Nr. 08/L-235, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim kërkesa për huamarrje për 15,000,000.00 € (pesëmbëdhjetë milionë euro) për "Telekomin e Kosovës Sh. A.", subjekt i aprovimit nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, me qëllim përmbushjen e planit investiv.
2. Obligohet Thesari që për huadhënien ndaj Ndërmarrjes Publike të bëjë transferet dhe regjistrimet e nevojshme në regjistrat kontabël në kuadër të Sistemit Informatik për Menaxhimin e Financave të Kosovës.
3. Mjetet e huadhënies sipas këtij Vendimi përdoren vetëm për qëllimin e miratuar dhe nuk janë subjekt i asnjë kufizimi, pretendimi dhe detyrimi nga palët e treta.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/165
Datë: 12.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 14, paragrafi 1. të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-213 dhe Ligjin Nr. 08/L-235, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për ndarjen të mjeteve buxhetore shtesë, në shumë prej 300,000.00 € (treqind mijë euro), për Projektin "Sanimi i Rrëshqitjes në Rrugën Nacionale N22.3", segmenti Mitrovicë-Jarinjë tek vendi i quajtur "Kërshi i Kajushës".
2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 232, nga nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 13100, nga kategoria e shpenzimeve "Shpenzime Kapitale" nga Projekti "Shpenzimet e Paparashikueshme 2019-2023" me kod 13255, dhe transferohen në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me kod 205, në kategorinë e shpenzimeve "Shpenzime Kapitale" në nën-programin "Rehabilitimi i Rrugëve" me kod 41800, në Projektin "Sanimi i Rrëshqitjes në Rrugën Nacionale N22.3", segmenti Mitrovicë - Jarinjë tek vendi i quajtur "Kërshi i Kajushës", me kod 16075.
3. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/165
Datë: 12.10.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit Nr. 04/L-163 për Mallrat e Liruar nga Tatimi Doganor dhe Mallrat me Tarifë Zero të Tatimit Doganor, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për lirim zero nga tatimi doganor për:
 - 1.1. Mallrat (pjesët rezerve të makinerive që përdoren në proces të prodhimit) për të gjithë prodhuesit që importojnë vet ose përmes kontraktuesit të cilët janë të autorizuar nga Administrata Tatimore e Kosovës për shtyrje të TVSh-së ose janë subjekte të autorizuar për procedurën e përpunimit të brendshëm nga Dogana e Kosovës;
 - 1.2. Mallrat (pjesë dhe aksesore) për të gjithë prodhuesit që importojnë vet ose përmes kontraktuesit të cilët janë të autorizuar nga Administrata Tatimore e Kosovës për shtyrje të TVSh-së dhe Dogana e Kosovës, të përcaktuara me shtojcën 1. të këtij Vendimi;
 - 1.3. Mallrat (kanoçe dhe mbyllëse) për të gjithë prodhuesit që importojnë vet ose përmes kontraktuesit të cilët janë të autorizuar nga Administrata Tatimore e Kosovës për shtyrje të TVSh-së dhe Dogana e Kosovës, të përcaktuara me shtojcën 2. të këtij Vendimi.
2. Dogana e Kosovës liron subjektin e lartë shënuar në pikën 1.2 dhe 1.3 të këtij Vendimi, me rastin e deklarimit të mallit për zhdoganim përmes Deklaratës Unike Doganore, dhe në rastet e importit nga kontraktori, në rubrikën Nr. 9 të deklaratës do të vendoset emri dhe numri unik identifikues i cili është i autorizuar nga Administrata Tatimore e Kosovës për shtyrje të TVSh-së dhe autorizimin për lirim nga Dogana e Kosovës. Dogana Kosovës do të mbajë evidencë të saktë përmes sistemit ASYCUDA dhe për çdo lirim në kohë reale do të njoftohet Administrata Tatimore e Kosovës për qëllim të implementimit të legjislacionit në fuqi.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e plotë të këtij Vendimi.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 08/40 i datës 11 prill 2018.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Shtojca 1.

8714 91	-- Trupat dhe pirunët, dhe pjesët e tyre:
8714 9110	--- Trupat, për biçikleta.
8714 9130	--- Pirunët e përparme për biçikleta
8714 9190	--- Pjesët për biçikleta
8714 92	-- Disqet dhe telat e rrotave:
8714 9210	--- Disqet e rrotave për biçikleta
8714 9290	--- Telat e rrotave për biçikleta
8714 9300	-- Bucelat, të ndryshme nga bucelat me frena dhe frenat e bucelës, dhe rrotat e lira dhe rrota yll për biçikleta
8714 94	-- Frenat, përfshi bucelat me frena dhe frenat e bucelës dhe pjesët e tyre:
8714 9420	--- Frenat për biçikleta
8714 9490	--- Pjesët për biçikleta
8714 9500	-- Shalat për biçikleta
8714 96	-- Pedalet dhe mekanizmi bjelle-manivele, dhe pjesët e tyre:
8714 9610	--- Pedalet për biçikleta
8714 9630	--- Mekanizmi bjelle-manivele për biçikleta
8714 9690	--- Pjesët për biçikleta
8714 99	-- Të tjera:
8714 9910	--- Timonët për biçikleta
8714 9930	--- Mbjajtëset e bagazhit për biçikleta
8714 9950	--- Mekanizmat e ndryshimit të lëvizjes së zinxhirit për biçikleta
8714 9990	--- Të tjera; pjesët për biçikleta
4011 5000	- Të një lloji të përdorur në biçikleta
4013 2000	- Të një lloji të përdorur në biçikleta
7315 8100	-- Zinxhir me hallka petë në tërheqje për biçikleta
4202 9900	-- Të tjera për biçikleta
8504 4055	----- Të tjera për biçikleta

8507 6000	- Akumulator Litium-Jon për biçikleta
8512 1000	- Ndriçuesit ose pajisje të sinjalizimit vizual të një lloji të përdorur në biçikleta
8544 4290	- - - Të tjera për biçikleta
9029 20	- Treguesit e shpejtësive dhe takimet; stroboskopët, për biçikleta

Shtojca 2

7310 21	- - Kanoçe të cilat duhet të mbyllen me saldim apo përkulje:
7310 2111	- - - Kanoçe të një lloji të përdorur për ruajtjen e ushqimeve
7310 2119	- - - Kanoçe të një lloji të përdorur për ruajtjen e pijeve
8309 9099	- - - Mbyllëse për Kanoçe të një lloji të përdorur për ruajtjen ushqimeve dhe e pijeve.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/165
Datë: 12.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 5 dhe 6 të Rregullores mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Pjesëmarrja e Komunave në Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Rregulloren Nr. 19/2015, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Ndërmarrja Publike Lokale "Dardana" Sh. A. Kamenicë me 100% aksione nga Komuna e Kamenicës.
2. Komuna e Kamenicës autorizohet që të veprojë në emër të aksionarit të vetëm NPL "Dardana" Sh. A. dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e ligjshme duke përfshirë regjistrimin sipas Ligjit Nr.02/L-016 për Shoqëritë Tregtare.
3. Komuna e Kamenicës, të drejtat e saj të aksionarit do t'i ushtrojë nga Komisioni Komunal i Aksionarëve, në emër të Komunës përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Komuna e Kamenicës për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/165
Datë: 12.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 5 dhe 6 të Rregullores mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Pjesëmarrja e Komunave në Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Rregulloren Nr. 19/2015, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Ndërmarrja Publike Lokale "Eko-Llapi" Sh. A. Podujevë me 100% aksione nga Komuna e Podujevës.
2. Komuna e Podujevës autorizohet që të veprojë në emër të aksionarit të vetëm NPL "Eko-Llapi" Sh. A. dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e ligjshme duke përfshirë regjistrimin sipas Ligjit Nr.02/L-016 për Shoqëritë Tregtare.
3. Komuna e Podujevës, të drejtat e saj të aksionarit do t'i ushtrojë nga Komisioni Komunal i Aksionarëve, në emër të Komunës përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Komuna e Podujevës për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/165
Datë: 12.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 5 dhe 6 të Rregullores mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Pjesëmarrja e Komunave në Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Rregulloren Nr. 19/2015, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet ndërmarrja publike lokale "Eko-Theranda" Sh. A. Suharekë me 100% aksione nga Komuna e Suharekës.
2. Komuna e Suharekës autorizohet që të veprojë në emër të aksionarit të vetëm NPL "Eko-Theranda" Sh. A dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e ligjshme duke përfshirë regjistrimin sipas Ligjit Nr.02/L-016 për Shoqëritë Tregtare.
3. Komuna e Suharekës, të drejtat e saj të aksionarit do t'i ushtrojë nga Komisioni Komunal i Aksionarëve, në emër të Komunës përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Komuna e Suharekës për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/165
Datë: 12.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe nenit 17 të Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. I propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës miratimi e Statutit të ri të Universitetit Publik "Hasan Prishtina" në Prishtinë.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Statutin nga pika 1. e këtij Vendimi t'ia dërgoj Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/165
Datë: 12.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia e Kosovës për Qeverisje Elektronike 2023-2027, dhe Plani i Veprimit.
2. Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme caktohet Koordinator Nacional për Qeverisje Elektronike, i cili këtë përgjegjësi mund ta delegoj te njëri nga zëvendësministrat e Ministrisë së Punëve të Brendshme.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/165
Datë: 12.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia Kombëtare për Siguri Kibernetike 2023-2027, dhe Plani i Veprimit.
2. Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme caktohet Koordinator Nacional për Sigurinë Kibernetike, i cili këtë përgjegjësi mund ta delegoj te njëri nga zëvendësministrat e Ministrisë së Punëve të Brendshme.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/165
Datë: 12.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani i Veprimit i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e rekomandimeve të Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2022, sipas shtojcës së bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Obligohen të gjitha organizatat buxhetore për zbatimin e Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2022.
3. Niveli i zbatimit të rekomandimeve do të monitorohet nga një mekanizëm i cili përcaktohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në koordinim dhe me mbështetjen e Zyrës së Kryeministrit.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/165
Datë: 12.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2023 -2030.
2. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/165
Datë: 12.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për "Amendamentimin Nr. 3. të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2015".
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/165
Datë: 12.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për "Amendamentimin Nr. 2. të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2016.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/165
Datë: 12.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për "Amendamentimin Nr. 1. të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2020".
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/165
Datë: 12.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për "Amendamentimin Nr. 1. të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2021.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/165
Datë: 12.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për "Amendamentimin Nr.1 të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2022".
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/165
Datë: 12.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 5 të Ligjit Nr. 08/L-033 për Provimin e Jurisprudencës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Drejtësisë për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, në këtë përbërje:
 - 1.1 Fejzullah Rexhepi, Kryetar i Komisionit dhe zëvendëskryetar i Komisionit Faton Bajrami, pyetës për lëndën: E Drejta Civile (materiale dhe procedurale);
 - 1.2 Sebahate Hoxha, anëtare dhe zëvendësanëtar Ersan Qavolli, pyetës për lëndën: E Drejta Penale (materiale dhe procedurale);
 - 1.3 Nora Bllaca - Dula, anëtare dhe zëvendësanëtare Afërdita Mulhaxha, pyetës për lëndën: E Drejta Kushtetuese dhe Bazat e Sistemit Gjyqësor;
 - 1.4 Franciska Ymeri - Zhitia, anëtare dhe zëvendësanëtare Saranda Bogaj - Sheremeti, pyetës për lëndën: E Drejta Tregtare, e Drejta e Punës dhe e Drejta Administrative; dhe
 - 1.5 Rustem Thaçi, anëtar dhe zëvendësanëtare, Javorka Prlinčević pyetës për lëndën: E Drejta Ndërkombëtare (private dhe publike) dhe E Drejta e Bashkimit Evropian.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Komisionin sipas pikës 1. të këtij Vendimi të ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 21/165
Datë: 12.10.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 7, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: Mbrojtja dhe Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore, Konservimi dhe Investimi në "Lokalitetin Arkeologjik Municipiumi Ulpiana - Justiniana Secunda" pjesë e trashëgimisë në mbrojtje të përhershme (Nr. unik TKRKS2A001) Zona Kadastrale Graçanicë, Komuna e Graçanicës, sipas tabelës të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8. paragrafi 8. të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Kompensimi i pronave të shpronësuara dhe të gjitha obligimet tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit dhe vlerësimit do të bëhet nga buxheti i Subjektit Kërkues/Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit(MKRS).
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/ Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 22/165
Datë: 12.10.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3, 4, 8 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: Ndërtimi i Rrugës Prizren-Kufiri me Maqedoninë e Veriut (Tetovë), segmenti Struzhë-Kyçja me Autoudhën "Ibrahim Rugova" në Prizren-Jug, L=20.350km, Zonat Kadastrale: Prizren, Vllashnje, Leskovec, Jabllanicë dhe Kushtendil, Komuna Prizren, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 23/165
Datë: 12.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 6, paragrafi 4. të Rregullores Nr. 11/2023 për Ekspertët, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Lista e Ekspertëve e kategorizuar sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe të gjitha institucionet tjera përkatëse për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është e bashkëngjitur edhe lista e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike dhe ekspertëve të kategorizuar sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Komisioni për vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike

**RAPORT I PUNES SË KOMISIONIT PËR VLERESIMIN E SISTEMEVE SHTETËRORE TË
INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT ME RËNDËSI STRATEGJIKE**

Qeveria e Kosovës me datë 08.03.2023, me vendimin nr. 07/132, ka themeluar komisionin për vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike.

Fillimisht komisioni ka përgatitur pyetësin për aplikim të institucioneve për sisteme me rëndësi strategjike, të cilin e ka harmonizuar me rregulloren (QRK) nr.11/2023 për ekspertët.

Më datë 13.03.2023 u është dërguar njoftimi bashkë me pyetësin të gjithë zyrtarëve më të lartë administrativ të institucioneve dhe u është kërkuar që deri më datë 24.03.2023 të plotësojnë pyetësin dhe ta përcjellin në e-mailin zyrtar të komisionit.

Pas pranimit të pyetësorëve të dërguar nga institucionet e Republikës së Kosovës, komisioni ka filluar më procesin e vlerësimit të kërkesave.

Metodologjia e realizimit të punës së komisionit është bazuar në:

- Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, nr. 08-L-196, neni 38 kompensim për funksion shtesë, shtojca 14.4 për ekspertet, dhe Rregulloren Nr. 11/2023 për Ekspertët;

- Identifikimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike duke u bazuar në rregulloren Nr. 11/2023 për Ekspertët;

- Kërkesat dhe informacionet e dërguara nga institucionet në pyetësin e plotësuar. Vlen të ceket që secili institucion mban përgjegjësi për saktësinë e informacioneve të dërguara;

- Pas plotësimit të kritereve të përcaktuara që një sistem i informacionit dhe komunikimit i përket kategorisë "sistemet shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike", janë analizuar pozitat që kanë përgjegjësi në menaxhimin, koordinimin dhe administrimin e atyre sistemeve të informacionit dhe komunikimit;

- Të gjitha pozitat janë kategorizuar sipas shtojcës 14.4 për ekspertet dhe për pozita të tjera do të kërkohet vendimmarrje nga nivelet e tjera për shkak se nuk janë pjesë e listës së pozitave sipas shtojcës 14.4 për ekspertët;

-Komisioni gjatë procesit të punës ka vlerësuar se disa institucione duhet të ftohen në takim për shkak se në pyetësor kanë munguar informata në bazë të cilave komisioni do të bënte vlerësimin e duhur (Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, ARKEP, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe Agjencia e Kosovës për Forenzikë). Komisioni ka mbajtur takime me institucionet e lartcekura dhe bazuar ne informatat e pranuar, ka realizuar vlerësimin për këto institucione.

Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike ka vlerësuar se disa nga institucionet e rëndësishme siç janë: Zyra e Presidentes, Zyra e Kryeministrit, Gjykata Kushtetuese, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Zyra Kombëtare e Auditimit, etj., nuk posedojnë sisteme me rëndësi strategjike mirëpo për shkak të rëndësisë së vet institucionit, duhet të gjendet një mënyrë për të i kategorizuar edhe zyrtarët e këtyre institucioneve sipas shtojcës 14.4. Aktualisht, Komisioni ka rekomanduar që zyrtarët e këtyre institucioneve të përfshihen në listën e shtesave për kushtet e tregut të punës.

Më datë 19.07.2023, Komisioni për vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike, ka miratuar dhe dërguar raportin e punës së komisionit për vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike tek Sekretarët e Përgjithshëm në ZKM, MPB dhe MFPT. Pas dërgimit të raportit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka dërguar komente për raportin e komisionit. Duke u bazuar në komentet e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për zvogëlim të listës së ekspertëve dhe nevojës që në listën e ekspertëve të vendosen vetëm pozitat që janë të plotësuara më zyrtar, komisioni ka dërguar kërkesë tek institucionet që kanë pasur numrin më të madh të zyrtarëve, për rishikimin e pozitave dhe njoftimin e komisionit për pozitat e lira në institucionet e tyre. Si rezultat i kësaj, nga numri total prej 419 zyrtarëve që janë kategorizuar si pozita të ekspertëve në raportin e dërguar më datë 19.07.2023, kanë rezultuar se në listë gjinden 80 pozita të lira të cilat janë largu nga lista, po ashtu janë larguar edhe 66 pozita që kanë përgjegjësi mbështetjen/përkrahjen e zyrtarëve në përdorimin e pajisjeve dhe sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve.

Pozitat e plotësuara në institucione por që nuk janë përfshirë në listën e ekspertëve, do t'i dërgohen si rekomandime komisionit për shtesa për kushtet e tregut të punës për përfshirje dhe kategorizim në listën e shtesave.

LISTA E SISTEMEVE SHETËRORE TË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT ME RËNDËSI STRATEGJIKE DHE EKSPERTËVE TË KATEGORIZUAR SIPAS SHTOJCES 14.4 TË LIGJIT Nr. 08/L-196 PËR PAGAT NË SEKTORIN PUBLIK

Nr.	Emri i institucionit	Emri i sistemit të rrjetit dhe informacionit
1	Administrata Tatimore e Kosovës	SIGTAS Oracle Audit Vault and Data base Firewall "SMPEF-Sistemi për Menaxhimin e PEF-ve / SMPF - Portali i t/p SMPEF" Portali i jashtëm EDI Portali i brendshëm , sistemi raportues (Intraneti ne SharePoint) FATCA Infrastruktura e rrjetave të komunikimit dhe sigurisë Ueb faqja e ATK-s, Denoncimi i Punëdhënësit, Vërtetimi Tatimore Sistemet për Regjistrimin e aktiviteteve(Vizitat, Kontrollat, Mbledhje, Edukim) të zyrtarëve të ATK-es

		Sistemet për Menaxhimin e Certifikatës së TVSH-es, për Menaxhimin e Pasivizimit të Tatimpaguesve, për Menaxhimin Çregjistrimit të tatimpaguesve
		Interoperabiliteti
		Infrastrukturë/Sistem Tatimor/Administrim dhe Përkrahje
2	Agjencia e Regjistrimit Civil	Sistemi i Gjendjes Civile
		Sistemi i Regjistrimit të Automjeteve
		Sistemi i Aplikimit, personalizimit dhe lëshimit të letërnjoftimeve, pasaportave dhe patentë shoferëve
3	Agjencia e Statistikave të Kosovës	Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS)
		Regjistri i popullsisë
4	Agjencia Kadastrale e Kosovës	Sistemi i Informacioneve Kadastrale të Tokave në Kosovë - SIKTK (regjistri kadastral)
		Sistemi i Adresave - ARIS (Regjistri Adresave)
		Pozicionimi Satelitor i Kosovës - KOPOS
		Gjeoportali Shtetëror
5	Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave	GIS Portali i AME-së
		Sistemi i thirrjeve emergjente 112
6	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	Sistemi Nacional për Monitorimin e Spektrit (SNMS);
		Sistemi për Monitorimin e Kualitetit të shërbimeve të Komunikimeve Elektronike;
		Sistemi për Menaxhimin e Resurseve Frekuencore
		Sistemi i CERT-it Nacional (KOS-CERT)/Incident Response/Cyber Threat Intelligence.
7	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit	Sistemet e Informacionit për siguri Kibernetike qeveritare
		Sistemet e Informacionit në qendrën shtetërore e të dhënave
		Platforma eKosova
		Platforma e Interoperabilitetit-GG
		Sistemi i telefonis dhe rrjetit kompjuterik shtetëror
		Infrastruktura për hosting të aplikacioneve dhe data bazave përkatëse të IRK-ve në platformën Microsoft
		Infrastruktura për hosting të aplikacioneve dhe data bazave përkatëse të IRK-ve në platformën Open Source
		Sistemi elektronik për menaxhimin e pasurisë shtetërore e- Pasuria
		Sistemi i Intranetit të Komunave (SIK)
		Sistemit për Menaxhimin dhe Arkivimin Elektronik të Dokumenteve - SMAED
		Sistemi elektronik i kartelave identifikuese

		Sistemi i menaxhimit të vijueshmërisë në punë (SMVP)
8	Dogana e Kosovës	Active Directory dhe Email Server CISCO Firepower 2130 Next Generation Firewall (CISCO NGFË) GG Gateway Infrastruktura e rrjetit Sistemi Doganor Asycudaworld (AW) Checkpoint NGFË Sistemi Inteligjencës së Biznesit - COGNOS ENTRUST Identity Sistemi i kamerave (TVQM/CCTV) Sistemi doganor për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale - DPI (INES) Sistemi doganor i zbatimit të ligjit dhe menaxhimit të përmbajtjes (LES-ECM) Sistemi doganor - rrjeti kombëtar i zbatimit të doganave - national customs enforcement network (nCEN) Sistemi për Virtualizim VMware në Doganë e Kosovës Sistemi i Shkëmbimit Elektronik të të dhenave - SEED Sistemi për Menaxhimin e Stafit - SIMS Sistemi WATCH GUARD
9	Policia e Kosovës	Sistemi i Infrastrukturës së rrjetit të Policisë së Kosovës Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës (SIPK) Sistemi i Menaxhimit të Kufijve-SMK(ang.BMS) Sistemi i Menaxhimit të Resurseve të Policisë (PRIMS) Sistemi për Monitorimin e Automjeteve të Policisë së Kosovës (SMAP) Sistemi i Sigurisë Kibernetike Sistemi për menaxhim të Infrastrukturës harduerike dhe virtuale të Policisë së Kosovës Active Directory Domain Services (ADDS) i Policisë së Kosovës Sistemi i Postës elektronike (e-mail) të Policisë së Kosovës Sistemi i Kamerave të Sigurisë Sistemi i Linjave Emergjente 192/Sistemi i Telefonisë VoIP Sistemi i Radiokomunikimit Sistemi për fotografim, daktiloskopim digjital dhe identifikimi i personave të dyshuar(SPIS) Sistemi i Evidentimit të dëshmive Balistike dhe Gjurmimit (BERT) Sistemi automatik i shenjësimit - Global (Automated Targeting System - Global, ATS-G)

		Qendra Monitoruese, "Sistemi për Përgjime Ligjore"
		Sistemi për përcjellje(GPS) dhe monitorimit të fshehtë
		Sistemi i brendshëm i DIA-së
		Witness Protection Case Management System (POLYCOM)
		Sistemi për raportimin e krimeve kibernetike, sistemet për analizimin e të dhënave të ndryshme elektronike
10	Instituti i Mjekësisë Ligjore	Forensic Case Management System
11	Këshilli Prokurorial i Kosovës	Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMR)
		Qendra Primare e të Dhënave - Pallati i Drejtësisë
		Infrastruktura e Rrjetit dhe Komunikimit në KPK
12	Këshilli Gjyqësor Kosovës	Sistemi elektronik për menaxhimin e lëndëve SMIL
		Sistemi Qendror i Evidencës Penale Kombëtar-SQEPK
		Sistemi i audio incizimit
		Qendra Primare e të Dhënave / Rrjeti ËAN
13	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	Sistemi i prokurimit elektronik
14	Kuvendi i Kosovës	Data Qendra - sistemet e dhomës, serverët, aplikacionet softuerike dhe VoIP
15	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Rrjeti kompjuterik dhe siguria kibernetike në MFPT
		IT infrastruktura fizike dhe logjike
		Qendra e të dhënave e MFPT
		Sistemi i Programi të Investimeve Publike - PIP
		Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit
		Sistemi i Tatimit në Pronë
		Sistemi pensional i Kosovës
		Sistemi i Pensionit Kontributiv
		Skema e Ndhmës Sociale - SNS
		Sistemi i Data Warehouse (Deponia e të dhenave) -DwH, COST BI, Power BI .
16	Thesari i Kosovës	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës (SIMFK)
		Sistemi i Menaxhimit të Pagave për zyrtarë publik -PSM
17	Agjencia e Regjistrim të Bizneseve të Kosovës	E-Regjistri i bizneseve
18	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	Sistemi Informativ i Vizave të Kosovës -SIVK
		Sistemi i sigurte i komunikimit digjital (Network, DATA, VoIP & Video)
19	Ministria e Shëndetësisë	Sistemi Informativ Shëndetësor (BHIS+Moduli i Vaksinimit, Moduli i EPPV, Moduli i Vizitave ne Shtëpi)

20	Ministria e Punëve të Brendshme	Sistemi i informacionit më të dhënat për leje të armëve
		Sistemi i informacionit më të dhënat për Parandalim dhe Ri integrimin për personat e Radikalizuar (ICRS)
		Sistemi i informacionit më të dhënat për qytetarët e huaj, qytetarët që fitojnë/humbin shtetësinë, azilantët dhe migrantët
		Qendra e rimëkëmbjes së të dhënave në Deçan (Qendra e të dhënave)
		Sistemet për Qendrën Kombëtare për Menaxhimin Kufitar (CMS & BI)
		Sistemi automatik i shenjësimit - Global (Automated Targeting System - Global, ATS-G)
		Ngritja e sigurisë kibernetike, Sistemi për identifikim të dyfishtë (Two Factor Authentication) dhe enkriptim të shënimeve
		Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
		Sistemi Elektronik i Organizatave jo Qeveritare (SEOJQ)
21	Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës	goAML
22	Ministria e Ekonomisë	Regjistri i Infrastrukturës së Komunikimeve Elektronike - Atlasi Broadband
		Sistemi i Identifikimit dhe Nënshkrimit Elektronik
23	Ministria e Mbrojtjes	Sistemi Satelitor SATCOM
		Rrjeti mikrovalor i komunikimit (backbone)
		Sistemi i komunikimit me radio-pajisje komerciale
		Sistemi luftarak i Radio-rrjetit (Combat Network Radio)
24	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	Sistemi për Menaxhimin e të dhënave të Agjencisë - Data Management System of Agency (DMSA)
		Sistemi për Deklarimin dhe Regjistrimin e Pasurisë (SDRP)
25	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	Infrastruktura e rrjetave të komunikimit dhe sigurisë (ASA CISCO Firewall)
		Sistemi i Financave dhe Deklarimi Online
26	Universiteti i Prishtinës	Qendra e të Dhënave - Data Center
		Rrjeti i UP-së

Pas identifikimit të sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike, bazuar në pikën 3 të vendimit, komisioni ka përgatitur listën e pozitave për ekspert të kategorizuar sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Lista është përgatitur më pozitat e vlerësuara si ekspert për secilin institucion. Më poshtë gjendet tabela e pozitave.

Nr.	Institucioni	Nr. Rendor per pozita	Emërtimi i pozites sipas institucionit	Numri i pozitive te propozuara	Kategorizimi i pozites
1	Administrata e Tatimore Kosovës	1	Drejtori i Departamentit te TI-se	1	B2
		2	Udhëheqës i Divizionit të Administrimit të Sistemit.	1	B3
		3	Udhëheqës i Divizionit të Zhvillimit të Aplikacioneve	1	B3
		4	Udhëheqës i Divizionit të Mirëmbajtjes dhe Përkrahjes së Aplikacionit Bazë	1	B3
		5	Administrator i lartë i bazës së të dhënave	4	B5
		6	Administrator i lartë i sistemit në TI	3	B5
		7	Administrator i lartë i rrjetit dhe Sigurisë	1	B4
		8	Administrator i lartë i rrjetit	1	B5
		9	Zhvillues dhe Administratore i larte i Sistemeve softuerike	4	B4
		10	Analist i lartë i sistemit	1	B5
		11	Analist i sistemit	2	B5
		12	Analist i aplikacionit bazë	3	B5
		13	Administrator i lartë për mirëmbajtje të ueb faqes	1	B5
			Total i pozitive për ATK:	13	Total i zyrtarëve për ATK:
2	Agjencia e Regjistrimit Civil	1	Udhëheqës i Sektorit për Administrimin e Bazave të të Dhënave	1	B3
		2	Administrator i TI-së për Backup	1	B6
		3	Administrator i TI-së për Sisteme Softuerike	1	B6
		4	Udhëheqës i Sektorit AFIS dhe Sisteme	1	B3
		5	Zhvillues Softuer	1	B5
		6	Administrator i bazës së të dhënave	1	B6
		7	Administrator i lartë i bazës për Patent Shofer dhe Pasaporta	1	B5
		8	Administrator i lartë për leternjoftime	1	B5
		9	Administrator për leternjoftime	1	B6
		10	Administrator i sistemeve	4	B6
		11	Administrator i lartë i sistemeve	1	B5
		12	Administrator i lartë i TI-së për Baza të të Dhënave	1	B5
		13	Administrator i TI-së per sisteme	1	B6
			Total i pozitive për ARC:	13	Total i zyrtarëve për ARC:
3	Agjencia e Statistikave të Kosovës	1	Udhëheqës i divizionit te teknologjisë informative	1	B3
		2	Zhvillues i lartë i aplikacioneve	1	B4
		3	Zyrtar i lartë për Teknologji Informative dhe GIS	1	B7
		4	Drejtor i departamentit te TI dhe Metodologjise	1	B2

		5	Administrator i lartë i bazës së të dhënave	1	B5
		6	Administrator i bazës së të dhënave	1	B6
		7	Administrator i Lartë i TI-së për Sisteme	1	B5
	Total i pozitive për ASK:	7	Total i zyrtarëve për ASK:	7	
4	Agjencia Kadastrale e Kosovës	1	Drejtor i Drejtoratit për Teknologji të Informacionit	1	B2
		2	Administrator i lartë i TI për siguri	2	B4
		3	Zhvilluese/administratore e lartë e databazave	1	B4
		4	Administratore e Lartë e TI-së për Baza të të Dhënave	1	B4
		5	Administratore e Lartë e TI-së për Sisteme Softuerike	1	B5
		6	Administrator i Lartë i TI-së për Sisteme	1	B5
		Total i pozitive për AKK:	6	Total i zyrtarëve për AKK:	7
5	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	1	Shef i Departamentit për Menaxhimin e Frekuencave	1	B2
		2	Zyrtare e Lartë për Përcaktim, Autorizim dhe Databaza	1	B7
		3	Zyrtar për Radiokomunikim	1	B8
		4	Zyrtar për Planifikim të Frekuencave dhe Databaze	1	B8
		5	Shef i Departamentit për Komunikimet Elektronike	1	B2
		6	Zyrtar i Lartë për kualitet të shërbimeve dhe infrastrukturë	1	B7
		7	Zyrtar i Lartë për Siguri të Rrjetave	1	B4
		8	Analist i siguris kibernetike	1	B5
		9	Menaxher i sistemeve, rrjetit dhe specialist për GIS	1	B7
		10	Shef i Departamentit të Radio Monitorimit dhe Inspektimit	1	B2
		11	Zyrtar i Lartë i Radio Monitorimit	2	B7
		12	Zyrtar i lartë për përcaktim dhe mbikëqyrje të frekuencave	1	B7
		13	Zyrtar i Lartë i Radio Monitorimit/Inspektor	1	B7
		Total i pozitive për ARKEP:	13	Total i zyrtarëve për ARKEP:	14
6	Agjencia e Shoqëris se Informacionit	1	Drejtor i Pergjithshëm i Agjencisë për Shoqëri të Informacionit	1	B1
		2	Drejtor i Drejtoratit të Operimeve Qendrore dhe Sigurisë	1	B2
		3	Udhëheqës i Sektorit të Sigurisë së TI-së	1	B3
		4	Administrator i lartë i TI-së për siguri kibernetike	1	B4
		5	Administrator i TI-së për Siguri	1	B5
		6	Udhëheqës i Sektorit të qendrës shtetërore të të dhënave elektronike	1	B3
		7	Administrator i Lartë i TI-së për Postën Elektronike	1	B5

		8	Administrator i Lartë i TI-së për Sisteme	1	B5
		9	Administrator i TI-së për Sisteme	2	B6
		10	Zyrtar i TI-së për Koordinim të e- Qeverisjes	1	B7
		11	Drejtor i Drejtoratit për Zhvillimin e eQeverisjes	1	B2
		12	Drejtor i Drejtoratit të rrjetave dhe telekomunikimeve	1	B2
		13	Udhëheqës i Sektorit të sistemit telefonik	1	B3
		14	Udhëheqës i Sektorit të Rrjetit Kompjuterik Shtetëror	1	B3
		15	Administrator i lartë i TI-së për Rrjetin Kompjuterik Shtetëror	2	B5
		16	Administrator i lartë i TI-së për Rrjetin Mikrovalor	2	B5
		17	Administrator i TI-së i Rrjetit Shtetëror	1	B6
		18	Administrator i TI-së për sistemet telefonike	1	B6
		19	Administrator i TI-së për Rrjetin mikrovalore	2	B6
		20	Drejtor i Drejtoratit për Menaxhim dhe Integrim të Sistemeve Softuerike	1	B2
		21	Administrator i IT-së për Sisteme Softuerike	1	B6
		22	Administrator i Lartë i Bazave të Dhënave	1	B5
		23	Administrator i Lartë i TI-së i Sistemeve Softuerike	1	B5
	Total i pozitave për ASH:	23	Total i zyrtarëve për ASH:	27	
7	Dogana e Kosovës	1	Udhëheqës i Sektorit për Sistemet	1	B3
		2	Administrator i lartë i sistemit dhe rrjetave	1	B5
		3	Administrator i lartë i sigurisë dhe backup-it	3	B5
		4	Administrator i lartë i sistemeve doganore	1	B5
		5	Administrator i lartë i sistemit	1	B5
		6	Zhvillues i lartë i aplikacioneve	1	B4
		7	Administrator i lartë i databazave	1	B5
		8	Analist i sistemeve dhe të dhënave	1	B5
		9	Udhëheqës i Sektorit ASYCUDA	1	B3
	Total i pozitave për DK:	9	Total i zyrtarëve për DK:	11	
8	Policia e Kosovës	1	Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë Informative dhe Komunikimit	1	B2
		2	Administrator i rrjetit	3	B6
		3	Administrator i sistemit mikrovalor	1	B6
		4	Specialist i Rrjetit	2	B7
		5	Specialist i antenave dhe shtyllave	2	B7
		6	Administrator i Bazës së të Dhënave	2	B6
		7	Inxhinier i Bazës së të Dhënave	1	B6

		8	Specialist i Bazës së të Dhënave	2	B7
		9	Zyrtar i lartë për zhvillimin dhe dizajnimin e aplikacioneve	1	B7
		10	Administrator i sigurisë së informatave	2	B4
		11	Administrator i sigurisë	1	B4
		12	Shef i Sektorit të Administrimit të sistemit	1	B3
		13	Administrator i sistemit	1	B6
		14	Udhëheqës i njësisë së administrimit të sistemit	1	B6
		15	Administrator i sistemit (email zyrtar)	1	B6
		16	Administrator i sistemit të kamerave	3	B6
		17	Specialist i sistemit të kamerave	1	B7
		18	Administrator i telefonisë	1	B6
		19	Inxhinier i Telekomit	1	B6
		20	Specialist i Telefonisë	3	B7
		21	Shef i njësisë së radiokomunikimit	1	B6
		22	Specialist i radiokomunikimit	5	B7
		23	Inxhinier i harduerit	2	B6
		24	Zyrtar i lartë i mirëmbajtjes së pajisjeve të IT-së	2	B7
		25	Zyrtar i Lartë i Administrimit të Paisjeve të TIK-ut	1	B7
		26	Specialist i harduerit	1	B7
		27	Ekspert i teknologjisë informative	2	B6
		28	Shef i Sektorit të Hetimit të Krimeve Kibernetike	1	B3
		29	Ekspert në Drejtorinë e Hetimit të Krimeve Kibernetike	8	B5
		30	Mbikëqyrës në Njësinë për Përgjim Ligjor	2	B6
		31	Specialist në Njësinë e Përgjimeve	2	B7
		32	Specialist i rrjetit të brendshëm	1	B7
	Total i pozitave për PK:	32	Total i zyrtarëve për PK:	59	
9	Instituti i Mjekesis Ligjore	1	Administratori i lartë i sistemeve	1	B5
		2	Menaxher i bazës së të dhënave	1	B6
	Total i pozitave për IML:	2	Total i zyrtarëve për IML:	2	
10	Keshilli Prokurorial i Kosoves	1	Udhëheqës i Departamentit të TI-së	1	B2
		2	Udhëheqës i Divizionit për Sisteme Elektronike (softuer)	1	B3
		3	Udhëheqës i Divizionit për Infrastruktur (rrjet dhe server)	1	B3
		4	Administrator i Lartë i TI-së për Baza të të Dhënave	1	B5
		5	Administrator i lart i TI-së për siguri	1	B4
		6	Administrator i Lartë i TI-së për Sisteme	2	B5
		7	Administrator i Lartë i TI-së për Rrjetin Shtetëror	1	B5
		8	Analist i lartë i Sistemit	2	B5

	Total i pozitive për KPK:	8	Total i zyrtarëve për KPK:	10	
11	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	1	Drejtor i Departamentit të Teknologjisë Informative	1	B2
		2	Udhëheqës i Divizionit për Infrastrukturë të Teknologjisë Informative	1	B3
		3	Administrator i Lartë i TI-së për Rrjetin Shtetëror	1	B5
		4	Administratore e Rrjetit të Evidences Penale	1	B6
		5	Administrator i TI-së për Baza të të Dhënave	2	B6
		6	Udhëheqesi i Divizionit për Aplikacione	1	B3
		7	Analist i lartë i TI për Sisteme	1	B5
		8	Administrator për Postë Elektronike dhe ueb-it	1	B6
		Total i pozitive për KGJK:	8	Total i zyrtarëve për KGJK:	9
12	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	1	Administrator i TI-së për Baza të të Dhënave	1	B6
		2	Ekspert i Larte i TI-se	1	B5
		3	Specialist i Larte i TI-se	1	B5
		Total i pozitive për KRRPP:	3	Total i zyrtarëve për KRRPP:	3
13	Kuvendi i Kosoves	1	Drejtor i Drejtorisë për Teknologji Informative	1	B2
		2	Administrator i sistemit	1	B6
		3	Zyrtar për rrjet kompjuterik (Administrator i rrjetit)	1	B6
		Total i pozitive për KK:	3	Total i zyrtarëve për KK:	3
14	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	1	Drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Sistemeve të TI-së	1	B2
		2	Udhëheqës i Divizionit për Infrastrukturë dhe Sigurinë e TI-së	1	B3
		3	Administrator i Lartë i TI-së për Rrjeta	1	B5
		4	Administrator i TI-së për Telefoni VoIP	1	B6
		5	Administrator i Lartë i TI-së për Sisteme	2	B5
		6	Administrator i TI-së për Sisteme	1	B6
		7	Udhëheqësi i Divizionit për menaxhimin e aplikacioneve	1	B3
		8	Zhvillues dhe Administrator i Lartë i Sistemeve Softuerike	4	B4
		9	Analiste e lartë i Sistemeve softuerike	1	B5
		10	Administrator i Lartë i Sistemeve Softuerike	1	B5
		11	Administrator i Lart i Bazes se te dhenave	1	B5
		Total i pozitive për MFPT:	11	Total i zyrtarëve për MFPT:	15
15	Thesari i Kosovës	1	Administratori i Lartë i Sistemit	2	B5
		2	Administratori i Lartë i Bazes së të dhënave	1	B5
		3	Administrator i Sistemit	1	B6

	Total i pozitive për ThK:	3	Total i zyrtarëve për ThK:	4	
16	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	1	Udhëheqës i Divizionit të TI-së	1	B3
		2	Administrator i lart i TI-së për sisteme	1	B5
		3	Administrator i sistemeve	1	B6
	Total i pozitive për MPJD:	3	Total i zyrtarëve për MPJD:	3	
17	Ministria e Shëndetësisë	2	Udhëheqës i Divizionit të Planifikimit Strategjik të SISh	1	B3
		4	Administrator i Lartë i TI-së për Rrjetin Shtetëror	1	B5
		5	Administrator i Lartë i TI-së për Baza të të Dhënave	2	B4
		6	Zhvillues dhe administrator i lartë i sistemeve souftverike	1	B4
		7	Administrator i TI-së për Sisteme	1	B6
	Total i pozitive për MSH:	7	Total i zyrtarëve për MSH:	6	
18	Ministria e Punëve të Brendshme	1	Drejtor i Departamentit për Siguri Kibernetike dhe Administrim të Sistemeve	1	B2
		2	Udhëheqës i Divizionit për Administrim të Aplikacioneve dhe Bazave të të Dhënave	1	B3
		3	Analist i sistemeve të TI-së	1	B5
		4	Zhvillues i lartë dhe administrator i bazave të të dhënave	1	B4
		5	Administrator për aplikacione dhe ueb aplikacione	1	B6
		6	Udhëheqës i Divizionit për Siguri dhe Administrim të Sistemeve	1	B3
		7	Administrator i TI për Siguri	1	B6
Total i pozitive për MPB:	7	Total i zyrtarëve për MPB:	7		
19	Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës	1	Udhëheqës i Sektorit të Teknologjisë Informative dhe Bazave të dhënave	1	B3
		2	Administrator i Bazës së të dhënave	1	B6
	Total i pozitive për NjIFK:	2	Total i zyrtarëve për NjIFK:	2	
20	Ministria e Ekonomisë	1	Drejtor i Departamentit të Teknologjisë Informative dhe Komunikuese	1	B2
		2	Udhëheqësi i Divizionit të Teknologjisë Informative	1	B3
		3	Udhëheqësi i Divizionit të Komunikimeve Elektronike (Telekomunikacionit)	1	B3
	Total i pozitive për ME:	3	Total i zyrtarëve për ME:	3	
21	Ministria e Mbrojtjes	1	Drejtor i Departamentit për Komunikim dhe Teknologji Informative	1	B2
		2	Shefi i Sektorit të Komunikimit dhe Transmetimeve	1	B3
		3	Shef i sektorit për Teknologji Informative	1	B3

		4	Shef i sektorit për mbrojtje kibernetike	1	B3
		5	Zyrtar për Siguri Kibernetike	1	B6
		6	Shef i Departamentit për Komunikim dhe Teknologji Informativ (ShPFSK)	1	B2
		7	Specialist i instalimeve dhe konfigurimeve	1	B7
		8	Administrator i sistemëve	2	B6
		9	Administrator senior i sistemëve	2	B5
		10	Administrator i aplikacioneve	2	B6
		11	Administrator i bazes së të dhënave	2	B6
		12	Specialist senior i rrjeteve	3	B6
		13	Administrator senior i rrjetave	1	B5
		14	Administrator i rrjetave	4	B6
		15	Analist i vlerësimit të cenueshmërive në rrjeta	1	B5
		16	Specialist i mbeshtetjes teknike per rrjeta	2	B7
		17	Komandant i njësis për mbrojtje kibernetike	1	B3
		18	Nënoficer i lartë për mbrojtje kibernetike	1	B5
		19	Reagues në incidente kibernetike	1	B5
		20	Analist për vlerësimin e cenueshmërive	1	B6
		21	Analist i mbrojtjes kibernetike	2	B6
		22	Nenoficer/specialist per testim	1	B7
		23	specialist për mbrojtje kibernetike	3	B7
	Total i pozitive për MM:	23	Total i zyrtarëve për MM:	36	
22	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	1	Administrator i Lartë i TI-së për Sisteme	1	B5
	Total i pozitive për APK:	1	Total i zyrtarëve për APK:	1	
23	Komisioni i Pavarur për dhe Minerale	1	Kryesues i Departamentit të Teknologjisë Informativ	1	B2
		2	Administrator i bazes së të dhënave	1	B6
	Total i pozitive për KPMM:	2	Total i zyrtarëve për KPMM:	2	
24	Universiteti i Prishtinës	1	Administrator i Rrjetit	1	B5
		2	Administrator i TI-së për Sisteme	1	B5
	Totali i pozitive për UP:	2	Total i zyrtarëve për UP:	2	

Numri total i pozitive është 200 ndërsa numri total i zyrtarëve në këto pozita është 273.

Komisioni për vlerësimin e sistemeve shtetërore më rëndësi strategjike:

Artan Dreshaj

A. Dreshaj

Elmi Podrimaj

E. Podrimaj

Vjosa Hoxha

V. Hoxha